



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/101
Datë: 20.10.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, dhe Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022, duke u bazuar në pikën 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 21/94 të datës 24 gusht 2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000,000.00 € (pesë milionë euro), për zbatimin e pikës 1.1 të Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022, lidhur me masat shitesë në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike në zbatim të Masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11301, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, për ekzekutimin e subvencionit për përfituesit e përzgjedhur sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Vendim të veçantë të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, sipas autorizimit të dhënë me pikën 3. të Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022.
4. Autorizohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të lidhë marrëveshje të veçantë me Furnizuesin e Shërbimit Publik, ku përcaktohen kushtet dhe kriteret, për zbatimin e pikës 1.1 të Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022.
5. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/101
Datë: 20.10.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, dhe Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 14,000,000.00 € (katërmëdhjetë milionë euro) për zbatimin e pikës 1.5 të Vendimit të Qeverisë Nr.31/99 të datës 30 shtator 2022, lidhur me masat shitesë në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike në zbatim të masës 3.6 - Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, për ekzekutimin e subvencionit për përfituesit e përzgjedhur sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Vendim të veçantë të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, sipas autorizimit të dhënë me pikën 3. të Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë